



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1487/1 Prot.

Tiranë, më 13.11.2018

V E N D I M

Nr. 230, datë 13. 11. 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 168, datë 25.10.2018, e E. S., kundër Zyrës Arsimore Lushnje dhe Shkollës së Mesme të Bashkuar Çermë Shkumbin, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”¹. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se ka përfunduar studimet e larta me kohë të plotë në degën Histori Gjeografi (sistemi 4 vjeçar), si dhe aktualisht ndjek vitin e dytë të studimeve Master Shkencor pranë Universitetit të Tiranës. Ka mbrojtur 3 (tre) gjuhë të huaja, si dhe ka publikuar disa botime shkencore në revista të ndryshme. Nga viti 2008, është punësuar si mësuese e Histori Gjeografisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar Çermë Shkumbin. Më datë 27.09.2018, drejtori i shkollës, H. L., ka njoftuar ankuesen lidhur me vlerësimin e vazhdimin të kontratës së punës. Sipas saj, nga ana e H. L. vazhdimisht është kërcënuar dhe është ushtruar presion psikologjik duke i thënë se nëse nuk firmos punën part-time do mbetej pa punë. Pa dijeninë e ankueses, H. L., ka dërguar dosjen e ankueses dhe të koleges së saj për vlerësim pranë Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve. Me anë të shkresës Nr. 247 prot., datë 29.09.2018, ankuesja është bërë me dije nga drejtuesit e shkollës se ndaj saj ka nisur procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Sipas ankueses, procesi i vlerësimit të dosjes së saj nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi pasi H. L. ka dërguar për vlerësim vetëm 2 dosje të 2 mësuesve dhe jo të gjithë mësuesve

¹ Referuar në informacionin e dhënë në ankesë, E. S. sqaron se ndjehet e diskriminuar për shkak të bindjeve politike pasi xhaxhai dhe vëllai i saj kanë qënë komisioner të Partisë Demokratike në proceset zgjedhore.

të shkollës së bashkuar Çermë Shkumbin.

Së fundmi, me anë të shkresës Nr. 255 prot., datë 05.10.2018, ankuesja është njoftuar nga drejtoria e shkollës lidhur me takimin që do të mbahet, në të cilin do të njihet me arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Në përfundim ankuesja kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike (pasi xhaxhai dhe vëllai i saj kanë qënë komisioner të Partisë Demokratike në proceset zgjedhore gjatë viteve 2007-2009) nga ana e drejtorit të Shkollës së Mesme të Bashkuar Çermë Shkumbin, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesja në rastin në fjalë nuk ka paraqitur prova, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesja në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion të shkurtër lidhur me pretendimin e saj, por nuk ka paraqitur fakte, prova apo informacion për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se largimi nga puna është bërë për shkak të cilësive të veçanta që ajo ka.

Në këto kushte dhe duke qënë se në formularin e ankesës ishte lënë kontakti i ankuseses, atëherë Komisioneri nëpërmjet e-mailit², datë 05.10.2018, i kërkoi informacion³, prova dhe fakte me anë të të cilave ankuesja argumenton shkaqet e pretenduara në ankesë dhe mohimin e shërbimit për shkak të cilësive të veçanta që ajo ka.

Më datë 09.11.2018, me anë të e-mailit, ankuesja vuri në dispozicion të KMD-së ankesat e drejtuara Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe portalit të bashkëqeverisjes (zyraebashkeqeverisjes@shqiperiaqeduam.al). Gjithashtu në e-mailin e dërguar ankuesja sqaroi se: *“Për vëllain dhe xhaxhain nuk munda të siguroj gjë. Vëllai im ka qënë sekretar i PD dega Përparim, Peqin 2007-2009, njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit të Komunës Përparim në këtë kohë. Mbetem me shpresë se do më ndihmoni pavarësisht dokumentave, e vërteta është që unë u hoqa politikisht nga puna, por ata mundohen ta kamuflojnë me dredhitë e tyre të ashtuquajtura ligjore. Këtë e tregojnë faktet nqs verifikohet në terren gjë që as ministria nuk e do sepse e di mirë çfarë po bën. Nqs shkojnë në shkollë do gjejnë 60% të mësuesve të pashkolluar dhe jashtë profilit, jo sic thonë për mua që jam ndër më të kualifikuarit atje.”*

Në kushtet që ankuesja nuk ka vënë në dispozicion prova dhe fakte me anë të të cilave të argumentojë shkakun e pretenduar në ankesë, si dhe referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku citohet se *“Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

² @@@@

³ - Kopje te dokumentacionit me anë të të cilit të vërtetohet aktiviteti politik i xhaxhait dhe vëllait të ankuseses (kartat e anëtarësisë në subjektin politik etj.),

- Kopje të dokumentacionit me anë të të cilit të vërtetohen lidhjet familjare me personat e sipërcituar,

- Kopje të të gjithë dokumentacionit që disponon ankuesja dhe mendohet që mund të ndihmojë në shqyrtimin e ankesës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32/1, germa a), nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, dhe 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së E. S., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)
(Fusha: Punësim)